

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**“COSMOS ATELIE” sh.p.k**

Sot, më datë 17/11/2022 u paraqitën personalisht:

1. Znj. Eliona GOLEMI me leternjoftim Nr. 032058734, i lëshuar me datë 25/01/2013 dhe Nr. Personal I35323082K, lindur në Durrës, me datë 23/04/1983 dhe banues në Durrës, Lagjja n. 12, Rr. Marin Barleti, Pallati strukturë 2002, ap 07D, Zona Kadastrale 8513.

Personi i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe në liri të plotë, në bazë të ligjeve shqiptare, themelon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**COSMOS ATELIE**” Shpk si vijon:

**Neni 1**

Subjektet e sipërpërmendura, me vullnetin e tyre të lirë dhe me liri të plotë, në bazë të ligjeve shqiptare, themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) të emërtuar “**COSMOS ATELIE**”sh.p.k.

Ortakët e kësaj shoqërie do të jenë:

1. **Znj. Eliona GOLEMI** me leternjoftim Nr. 032058734, i lëshuar me datë 25/01/2013 dhe Nr. Personal I35323082K, lindur në Durrës, me datë 23/04/1983 dhe banues në Durrës, Lagjja n. 12, Rr. Marin Barleti, Pallati strukturë 2002, ap 07D, Zona Kadastrale 8513, zotërues i një kuote me vlerë 100.000 LEK.

Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare dhe do të jetë:

1. **Znj. Eliona GOLEMI** me leternjoftim Nr. 032058734, i lëshuar me datë 25/01/2013 dhe Nr. Personal I35323082K, lindur në Durrës, me datë 23/04/1983 dhe banues në Durrës, Lagjja n. 12, Rr. Marin Barleti, Pallati strukturë 2002, ap 07D, Zona Kadastrale 8513.

Shoqëria ka të drejtën të krijojë filiale brenda dhe jashtë vendit në çdo moment që do të konsiderohet i përshtatshëm nga ana e saj dhe me aprovimin e organeve kompetente (Qendra Kombëtare e Regjistrimeve).

**Neni 2**


Shoqëria “**COSMOS ATELIE**” sh.p.k gëzon statusin e personit juridik. Aktiviteti i saj do të zhvillohet sipas pikave të paraqitura në këtë akt themelimi, statutit të saj dhe ligjeve në fuqi. Selia e shoqërisë do të jete: **Lagjja n. 12, Rr. Marin Barleti, Pallati strukturë 2002, ap 07D, Zona Kadastrale 8513, Durrës.**

Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë integrale e tij.

Shoqëria ka vulën e saj me mbishkrimin “**COSMOS ATELIE**” sh.p.k.

**Neni 3**

Aktiviteti i shoqërisë si person juridik fillon me miratimin e aktit të themelimit nga ana e organeve shtetërore kompetente dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore më të gjatë se 10 vjet.



#### Neni 4

Shoqëria ka si objekt aktiviteti:

1. Aktivitet në projektim, hartim dhe konsulencë të planeve rregulluese të përgjithshme për qendra të banuara dhe qytete. Hartim të studimeve pjesore urbanistike, të projekteve arkitektonike për objekte civile, industriale dhe turistike. Hartim të projekteve arkitektonike për objekte sportive, të projekteve të interierit. Hartim të projekteve të konstruksionit të objekteve civile, industriale dhe turistike prej murature e skelet beton-arme dhe me skelet metalik. Aktivitet në zbatim. Punime gërmimi nën tokë. Ndërtime civile dhe industriale, rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasadash. Shoqëria brenda hapësirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e sipërmarrjeve të tjera, si brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përmbushjen e veprimtarisë së saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Mbikqyrje dhe kolaudim në fushën e ndërtimit.

2. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e objektit të shoqërisë dhe midis të tjerash:

- Të kryejë veprime tregtare dhe industriale, financiare, hipotekore dhe pasurive të patundshme duke përfshirë blerjen, shitjen dhe shkëmbim e pasurive të patundshme dhe të luajtshme, edhe të regjistruara, pasurive të paluajtshme dhe të drejtave pasurish te paluajtshme, qiramarrje dhe me qiradhenie aktive dhe pasive të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, me përjashtim të qirave aktive financiare;

- Të zbatojë çdo formë të financimit (si dhe leasing-ut pasiv) me institutet e kredive, bankave, shoqërive dhe privatëve, duke dhënë garancitë e nevojshme reale dhe personale;

- Të japë garanci bankare, kambiale dhe garanci reale në favor të shoqërive kontrolluese, të kontrolluara dhe të lidhura dhe të kontrolluara nga një e vetme qoftë edhe në brendësi të të njëjtit grup;

- Të marrë pjesë në konsorciume, ose grupime shoqërishe dhe bashkim të përkohshëm shoqërishe;

- Të marrë pjesëmarrje dhe fitime në shoqëri e ndërmarrje sipas dispozitave ligjore gjithnjë në funksion të qëllimeve të shoqërisë, por jo në mënyrë ekskluzive.


Shoqëria mund të përdorë perfitimet fiskale, shoqërore dhe financiare të parashikuara sipas ligjeve në fuqi me ndryshimet e tyre, shtyrjet dhe modifikimet, për aktivitetin në objekt, si dhe nga çdo ligj tjetër lehtësues, si dhe lehtësimet e parashikuara nga Komuniteti European.

#### Neni 5

Kapitali i kësaj shoqërie është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i përbërë nga 1 kuotë, me vlerë 100.000 LEK.

#### Neni 6

Fitimi neto që do të përfitohet nga aktiviteti i kësaj shoqërie, nëse do të shpërndahet, do të caktohet ortakëve në bazë të kuotave të pjesëmarrjes që disponojnë në kapitalin e shoqërisë.



#### **Neni 7**

Për detyrimet ndaj të tretëve, që do të krijohen gjatë aktivitetit, shoqëria do të përgjigjet ekskluzivisht vetëm me kapitalin e saj. Për rrjedhojë, ortakët nuk do të kenë asnjë përgjegjësi për detyrimet e krijuara nga shoqëria, përveçse brenda kufijve të kapitalit të vetë shoqërisë.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri dhe filialet e saj rregullohen përmes Kontratës së Punës.

#### **Neni 9**

Dispozita më të thelluara mbi organizimin e kësaj shoqërie janë të specifikuar në statutin e shoqërisë.

Themeluesit e shoqërisë e kanë lexuar këtë akt themelimi, e kanë konsideruar të pranueshëm ndaj vullnetit të tyre dhe e kanë firmosur pa kundërshtime.

#### **ORTAKËT E SHOQËRISË**

Eliona Golemi  